 3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mostrat e kërkuara në tabelën e mëposhtme, dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, (fletë-analizë) të lëshuara nga laboratorë, të cilët duhet të jetë të akredituar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia matëse	Kërkesat e Proçedures
1	Xhup 3/4 sintetik	copë	1 (një) "emri i
2	Kostume dimërore (i zi)	komplet	

3	Këmishë me mëngë të gjata	copë	1 (nje) pjesë te lëndës se parë me gjatësi 0,5 ml, dhe gjerësi sa ajo e vet lëndës se parë.
5	Pulovër	copë	
6	Kravate	copë	
7	Kapele	copë	

Mostrat e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht skualifikues.

Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara me adrese: Bulevardi ”Deshmoret e Kombit”, Tiranë.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

Specifikimet Teknike

1. Kostum i zi, Dimëror (material i trashë) UNIFORME;

Kostumi i uniformës është realizuar me tekstil me ngjyrë të zezë dhe është konfeksionuar në prerje 42; 44-46-48-50-52-54-56-58-60-62-64).

Kostumi përbëhet nga xhaketa dhe pantallonat.

A. Xhaketa e uniformës për meshkuj

Xhaketa e uniformës është realizuar me tekstil të plotë dhe përbëhet nga këto elementë:

- Përpara (me dy pjesë)
- Dy pjesë anësore (fianket)
- Dy paramontura (mostra)
- Jaka
- Pjesa e pasme
- Dy mëngë
- Astari i brendshëm




Figura 1. Kostum i zi, Dimëror (material i trashë)

1. PËRPARA

Është realizuar me dy pjesë, të bashkuara me pjesët e tjera të xhaketës me anë të tegelit qepës. Dy pjesët përpara përfundojnë me një tegel rreth 1 mm nga dy bordurat e përparme përgjatë gjithë gjatësisë së tyre; të cilat përfundojnë në afërsi të jakës me kulme me majë.

Secila pjesë përpara është e përbërë përgjatë gjithë gjerësisë së saj nga dy shtresa tekstili për të krijuar një lirshmëri më të mirë.

- Shtresë e jashtme tekstili.
- Shtresë tekstili adezive (frazelinë) e aplikuar në brendësi të xhaketës

Gjithashtu në brendësi të secilës nga pjesët përpara, përgjatë linjës së supeve dhe linjës së gjoksit është vendosur një shtresë përforcuese e përbërë nga:

- Dy shtresa tekstili në brendësi të mbivendosura.
- Një shtresë me mbushje, vatinë e aplikuar përgjatë linjës së supeve.

Këto tre shtresa bashkohen ndërmjet tyre nëpërmjet një shtrese tjetër adezive (frazelinë) të aplikuar për gjatë gjithë gjatësisë së tyre.

Procesi i palosjes me anë të hekurit duhet të kryhet me teknikën e duhur në mënyrë që pjesët e palosura të mos krijojnë defekte në pamjen e jashtme.

Në secilën pjesë përpara janë aplikuar dy xhepa të pozicionuar poshtë linjës së belit.

- a. Xhepat e pozicionuar në linjën e gjoksit; me dimensione: gjerësi 13 cm dhe lartësi rreth 12,5 cm, janë modeluar në formë drejtkëndore me kulme të harkuara. Janë realizuar me tegel linear perimetral 1 mm nga bordet. Në brendësi janë përforcuar me një shtresë adezive (frazelinë).

Mbi secilin xhep është aplikuar kapaku i xhepit i realizuar me anë të tegelit linear një gjilpërësh perimetral rreth 1 mm nga bordet. Montimi i kapakut është realizuar me tegel linear një gjilpërësh me kthim pale rreth 5 mm. Kapaku i xhepit ka dimensione: lartësi rreth 5,5 cm dhe gjerësi rreth 13 cm. Përgjatë qendrës së kapakut të xhepit në distancë rreth 1 cm nga bordi fundor është aplikuar një vrimë me gjerësi rreth 20 mm, në korrespondencë me kopsën plastike të aplikuar në xhep. Në brendësi të kapakut është aplikuar astari realizuar me anë të tegelit linear perimetral një gjilpërësh.

- b. Xhepat e pozicionuar në pjesën e poshtme përpara; me dimensione: gjerësi rreth 18 cm dhe lartësi 17 cm janë realizuar në formë drejtkëndore me kulme të harkuara, të përshkuara me anë të tegelit linear perimetral rreth 1 mm nga bordet. Në qendër të secilit xhep, është aplikuar në drejtim vertikal një palë me gjerësi rreth 3 cm. Në distancë rreth 2 cm nga bordi i sipërm, përgjatë qendrës është aplikuar një kopsë plastike me ngjyrë të zezë. Mbi secilin xhep është aplikuar kapaku i xhepit realizuar me anë të tegelit linear një gjilpërësh perimetral rreth 1 mm nga bordet. Montimi i kapakut është realizuar me tegel linear një gjilpërësh me kthim pale në bordin e sipërm rreth 5 mm. Kapaku është realizuar me tekstil dopio të njëjtë me atë të xhakëtës të përshkuar në tre drejtimet e lira me anë të tegelit linear perimetral një gjilpërësh. Në brendësi të kapakut përgjatë gjithë gjerësisë së tij është aplikuar astar realizuar me tegel qepës perimetral.

Në secilën nga pjesët përpara është aplikuar një pencë, në pozicion vertikal, ndërmjet dy xhepave, për të patur një lirshmëri më të madhe. Në të majtë të veshur janë aplikuar katër vrima, të pozicionuara në drejtim horizontal me hapje rreth 25 mm të aplikuara në distancë rreth 1 m nga bordi qendror, të barazlanguara rreth 8,5 cm nga njëra - tjetra. Vrima e parë është pozicionuar në afërsi të pjesës së kthyer. Në korrespondencë me to në të djathtë të veshur janë aplikuar katër kopsa plastike të cilat bëjnë të mundur bashkimin e pjesëve përpara.

Linja fundore e secilës pjesë përpara përfundon me një kthim pale rreth 3 cm, në brendësi të së cilës është aplikuar një shirit tekstili adeziv me lartësi rreth 4 cm (ngjitës pale) i cili shërben për fiksimin e kthimit të palës.

2. ANËSORET (FIANKET)

Janë dy pjesë tekstili të aplikuara në linjën anësore me vazhdim në pjesën përpara dhe prapa. Këto pjesë janë të aplikuara në drejtim vertikal dhe bëjnë të mundur bashkimin e pjesëve përpara me pjesët prapa. Në to nuk është aplikuar asnjë përforcim i brendshëm.

3. PARAMONTURA (MOSTRA)

Janë dy pjesë tekstili të montuara përgjatë bordurës qendrore përpara, nga brenda, përgjatë gjithë gjatësisë së xhakëtës një në të djathtë dhe një në të majtë, në drejtim vertikal; të bashkuara me pjesët përpara, astarin dhe jakën me tegel qepës një gjilpërësh. Në brendësi të secilës paramonturë (mostër) ndërmjet astarit dhe tekstilit të jashtëm është aplikuar një shtresë tekstili adezive (frazelinë) duke j'u përshtatur tekstilit të xhakëtës. Secila paramonturë është bashkuar me bordurën qendrore me anë të tegelit qepës një gjilpërësh rreth 1 mm nga bordi i bashkimit të secilës pjesë përpara dhe në të njëjtën pikë është aplikuar një tegel zbukurues me fill me ngjyrë të kuqe rreth 1 mm në anë e astarit për efekt estetik.

4. JAKA

Është realizuar tekstil me ngjyrë të zezë: e cila është pjesa e dukshme me kulme të harkuara, e cila bashkohet me pjesën e brendshme. Është e përbërë nga dy shtresa; shtresa e sipërme e realizuar me tekstil dhe shtresa e brendshme me tekstil adeziv, frazelinë e cila shërben për përforcimin e jakës dhe për lirshmëri më të mirë. Pjesa e sipërme është përshkuar me tegel qepës një gjilpërësh rreth 1mm nga bordi.

5. PJESA PAS

Dy pjesët e pasme bashkohen ndërmjet tyre me anë të tegelit qepës në linjën qendrore prapa, në drejtim vertikal, nga tegeli bashkues i jakës deri në fillim të çarjes. Pjesët e pasme bashkohen me pjesët përpara me anë të tegelave qepës linear një gjilpërësh në linjën e supit, në anësor nëpërmjet dy pjesëve anësore me prerje; dhe në rrethin e mëngës.

Çarja e aplikuar përgjatë linjës qendrore prapa ka lartësi rreth 21 cm. Në bordin e sipërm çarja është realizuar me anë të tegelit qepës në drejtim transversal. Në të majtë të veshur të çarjes është aplikuar një palosje e brendshme me gjerësi rreth 4 cm; ndërsa anës së djathtë i është mbivendosur e majta. Të dyja anët paraqesin në brendësi të palosjes së tyre një shtresë tekstili termoadezive (frazelinë) e cila shërben për përforcim. Në brendësi të xhaketës ndërmjet teksilit të jashtëm dhe shtresës së brendshme në afërsi të linjës së supeve janë vendosur dy vata 100% në formë gjysmërrethore me drejtimin me linjë të drejtë të montuar në tegelin qepës të rrethit të mëngës dhe tre drejtimet e tjera të lira.

6. MËNGËT

Janë të realizuara me dy pjesë; mënga e sipërme dhe mënga e poshtme të bashkuara ndërmjet tyre me anë të tegelave qepës anësor dhe të poshtëm, një gjilpërësh.

Bordura përfundon me një kthim pale me lartësi rreth 3 cm e cila bashkohet me astarin në brendësi.

7. ASTARI I BRENDSHËM

Trupi i xhaketës, mëngët dhe xhepat janë realizuar nga brenda me astar.

Astari është i ndërtuar nga katër pjesë kryesore (dy pjesë përpara dhe dy pjesë pasme) të bashkuara ndërmjet tyre me anë të tegelit qepës një gjilpërësh dhe përfundon në linjën fundore me një shtesë rreth 1,5 cm.

B. Pantallona uniforme për meshkuj

Pantallonat për meshkuj janë realizuar sipas modelit klasik me të njëjtin tekstil si ai i xhaketës së uniformës dhe përbëhen nga këto elementë:

- Qemeri
- Dy këmbë
- Xhepa oblig

1. QEMERI

Është realizuar në dy pjesë të bashkuara në linjën qendrore të pjesës prapa, i përforcuar me frazelinë me gjerësi rreth 4 cm.

Është i përbërë nga këto elementë:

- Shtresa e jashtme ballore realizuar me tekstil ë zi
- Shtresa e brendshme me frazelinë e cila shërben për përforcim.

Në të majtë përpara të qemerit është aplikuar shtesë qemeri e modeluar me kulme në të cilin është aplikuar një vrimë horizontale prej 20 mm.

Në të djathtë përpara është e aplikuar një kopsë me fill qepës sintetik me 4 vrima (tegeli qepës i butonit është paralel dhe jo kryq) me ngjyrë të zezë në korrespondencë me vrimën e aplikuar në të majtë dhe në linjë me zinxhirin.

Përgjatë qemerit janë vendosur 6 kalues, me lartësi 5 cm dhe gjerësi 18 mm, me një hapësirë të brendshme rreth 5 cm, të montuar dhe të fiksuar me tegel përforcues lart në qemer nga jashtë dhe poshtë në pjesën e brendshme të qemerit. Kaluesit janë realizuar me tekstil dopio të njëjtë me atë të pantallonit.

Kaluesit janë aplikuar: 2 në pjesët përpara (njëri në të djathtë dhe tjetri në të majtë); 4 në pjesën e pasme të pozicionuar dy në një distancë rreth 6 cm nga tegeli qepës në linjën qendrore prapa të qemerit (një kalues në anën e djathtë dhe një kalues në anën e majtë) ndërsa 2 kaluesit e tjerë të barazlanguar.

2. KËMBËT

Secila këmbë është e përbërë nga pjesa e përparme dhe pjesa e prapme të bashkuara me tegel linear një gjilpërësh. Në secilën pjesë të pasme, ndërmjet qemerit dhe xhepit, është realizuar një pencë vertikale përgjatë butonit të xhepit. Në linjën qendrore të pantallonit është montuar sallkia. Sallkia është e formuar nga dy pjesë: nga pjesa e poshtme mostra (e padukshme) dhe pjesa e sipërme kundër mostra (e dukshme) të profiluara respektivisht e para me tekstil dhe e dyta me astar. Pjesa e djathtë kundër mostra (pjesa e dukshme) në brendësi përfundon në formën e kavallos, me të njëjtin tekstil astar të aplikuar në pjesën e poshtme dhe fiksohet në dy ekstrimitetet e tegelit qepës të këmbës nga brenda.

Pjesa e sipërme dhe e poshtme e sallkisë janë montuar në distancë rreth 8 cm nga tegeli qepës i kavallos. Në sallki është aplikuar një zinxhir tip 3 fiks me tonalitet të njëjtë me teksitilin e pantallonave, gjatësia e të cilit varion 16 deri 20 cm në bazë të prerjes.

Këmbët përfundojnë të modeluara në pjesën fundore me tegel qepës syzator.

3. XHEPAT

Në pantallona janë të montuar dy xhepa në pjesën përpara të pozicionuara në anësorë, janë model francez (xhep oblig).

- **Xhepat oblig anësorë:** janë të pjerrët dhe fillojnë nga linja e qemerit me një distancë rreth 3 cm nga linja anësore (tegeli qepës në linjën anësore) në pjesën e sipërme, ndërsa në pjesën e poshtme xhepat montohen në tegelin qepës të linjës anësore. Hapja e xhepit është rreth 16 cm dhe është rforcuar në ekstrimitete me tegel qepës përforcues. Pjesa e brendshme e xhepit është e përbërë nga një mostër astari dhe nga një mostër me të njëjtin tekstil si ai i pantallonit në pjesën ballore. Xhepat në brendësi janë realizuar me tekstil.

TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ
(PËRMASAT E SHPREHURA NË CM – TOLERANCË +/- 3%)
Xhakët PRERJE (DROP) 2

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHS HME	GJATËSIA E XHAKETËS (nga tegeli bashkues i jakës deri në linjën fundore)	1/2 GJERËSISË SË SHPATULLAV E	GJATËSI MËNGE	PJERRËSI A E SUPEVE	1/2 PERIMETRIT TË KRAHARORIT
44	160,5	75	20,5	60	12,5	47

Dokumentat Standarde të Tenderit

46	163,5	75	21,5	61	12,5	49
48	166,5	76	22,5	62	13	51
50	167,5	77	23,5	63	13	53
52	173	78	24,5	64	13	55
54	176	79	25,5	65	13,5	57
56	179	80	26,5	66	13,5	59
58	182	80	27,5	67	13,5	61
60	182	80	28,5	68	14	63
62	182	80	29,5	69	14	65
64	182	80	30,5	70	14	67

Pantallona PRERJE (DROP) 2

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHSHME	1/2 PERIMETRIT TË BELIT	GJERËSIA E PANTALLONIT NË LINJËN FUNDORË	GJATËSIA E KËMBËS NGA JASHTË (PA QEMERIN))	GJATËSIA E KËMBËS NGA BRENDA
44	160,5	42	22	109	87
46	163,5	44	22	109	87
48	166,5	46	22,5	110	88
50	167,5	48	22,5	110	88
52	173	50	22,5	110	88
54	176	52	22,5	111	89
56	179	54	23	111	89
58	182	56	23	111	89
60	182	58	23	111	89
62	182	60	23	111	89
64	182	62	23	111	89

TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ
(PËRMASAT E SHPREHURA NË CM – TOLERANCË +/- 3%)

Xhakëtë PRERJE (DROP) 4

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHSHME	GJATËSIA E XHAKETËS (nga tegeli bashkues i jakës deri në linjën fundore)	1/2 GJERËSISË SË SHPATULLAVE	GJATË SI MËNGJE	PJERRËSIA E SUPEVE	1/2 PERIMETRIT TË KRAHARORIT
44	165	75	20,5	60	12,5	49
46	168	75	21,5	61	12,5	51
48	171,5	76	22,5	62	13	53
50	174,5	77	23,5	63	13	55
52	177	78	24,5	64	13	57

Dokumentat Standarde të Tenderit

54	179	79	25,5	65	13,5	59
56	181,5	80	26,5	66	13,5	61
58	183,5	80	27,5	67	13,5	63
60	183,5	80	28,5	68	14	65
62	183,5	80	29,5	69	14	67
64	183,5	80	30,5	70	14	69

Pantallona PRERJE (DROP)4

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHSHME	1/2 PERIMETRI T TË BELIT	GJERËSIA E PANTALLONIT NË LINJËN FUNDORË	GJATËSIA E KËMBËS NGA JASHTË (PA QEMERIN))	GJATËSIA E KËMBËS NGA BRENDA
44	165	40	22	109	87
46	168	42	22	109	87
48	171,5	44	22,5	110	88
50	174,5	46	22,5	110	88
52	177	48	22,5	110	88
54	179	50	22,5	111	89
56	181,5	52	23	111	89
58	183,5	54	23	111	89
60	183,5	56	23	111	89
62	183,5	58	23	111	89
64	183,5	60	23	111	89

TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ

(PËRMASAT E SHPREHURA NË CM – TOLERANCË +/- 3%)

Xhaketë PRERJE (DROP) 6

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHS HME	GJATËSIA E XHAKETËS (nga tegeli bashkues i jakës deri në linjën fundore)	1/2 GJERËSISË SË SHPATULLAVE	GJATËSI MËNGE		PJERRËSI A E SUPEVE	1/2 PERIMETRI T TË KRAHARORIT
44	166,5	75	20,5	60	12,5		51
46	169,5	75	21,5	61	12,5		53
48	173	76	22,5	62	13		55
50	176,5	77	23,5	63	13		57
52	178,5	78	24,5	64	13		59
54	180,5	79	25,5	65	13,5		61
56	183,5	80	26,5	66	13,5		63
58	185	80	27,5	67	13,5		65
60	186,5	80	28,5	68	14		67
62	187,5	80	29,5	69	14		69
64	187,5	80	30,5	70	14		71

Pantallona PRERJE (DROP)6

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHSHME	1/2 PERIMETRIT TË BELIT	GJERËSIA E PANTALLONIT NË LINJËN FUNDORË	GJATËSIA E KËMBËS NGA JASHTË (PA QEMERIN))	GJATËSIA E KËMBËS NGA BRENDA
44	166,5	38	21,5	109	87
46	169,5	40	21,5	109	87
48	173	42	21,5	110	88
50	176,5	44	21,5	110	88
52	178,5	46	22	110	88
54	180,5	48	22	111	89
56	183	50	22,5	111	89
58	185	52	22,5	111	89
60	186,5	54	22,5	111	89
62	187,5	56	23	111	89
64	187,5	58	23	111	89

Të dhëna teknike të lëndës së parë:

Masa: 280g/m ² ±3%	(S SH ISO 3801:1977)
Thurja: diagonale 2+2	(S SH ISO 7211-1:1984)
Përbërja: 45 % lesh + 55 poliestër ±3%	(ISO 1833-24:2010)
Qëndrueshmëria në abrazion: 10 000 cikle	(SSH EN ISO 12947-2:2016)
Efekti i kokërrizmit: Nota 4-5	(S SH EN ISO 12945-2:2005)
Qëndrueshmëria në larje	Nota 4-5
Kodi i ngjyrës: Pantone black 6C	

Aksesorët:

Të gjithë aksesorët mund të realizohen dhe me materiale të ngjashëm, por të jenë në përputhje me karakteristikat e specifikimeve teknike të kërkuara të produktit ose ekuivalente me to, karakteristika të tilla si: rezistenca, qëndrueshmëria.

2. PËRFORCUES:

- Artikulli : Rovatext 95 h. 150
- Ngjyra: E zezë
- Përmbarimi: RES.I/17

3. VATINA: 100% poliamid

5. Frazelinë PËR XHEPAT:

- Ngjyra: E zezë
- Përmbarimi: RES.I/17

6. Frazelinë PËR JAKËN:

- Artikulli: i padeformueshëm për jakën H. 150
- Ngjyra: E zezë
- Përmbarimi: RES. A/12

7. ASTARI I BREND SHËM:

- Lënda e parë: 100% viskozë
- Ngjyra: në tonalitë me produktin
- Hollësi filli: Baza 8,4x1 tex – Indi 13x1 tex
- Thurje: Sarzh
- Masa: 86 gr/m² ±3%

8. FILLI QEPËS :

- Fill me përbërje: 100% poliestër
- Hollësi: 75
- Qëndrueshmëria në tërheqje: jo më pak se 12 N
- Ngjyra: E njëjtë me atë të tekstilit

9. FILLI QEPËS PËR VRIMAT:

- Fill me përbërje: 100% poliestër
- Hollësi filli Nm: 70
- Qëndrueshmëria në tërheqje: jo më pak se 12 N
- Ngjyra: E njëjtë me atë të tekstilit

KOPSAT

Janë plastike me katër vrima me qepje në paralel dhe jo kryq (lineare) me madhësi 24, ngjyrë zezë.

➤ AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI I KOSTUMIT

Kostumi duhet të pajiset me një etiketë tekstili, në të cilën të shkruhet informacioni:

- Emri i prodhuesit
- Viti i prodhimit
- Masa (numri)
- Përbërja fibrore
- Instruksionet e mirëmbajtjes

Etiketa duhet të qepet në pjesën ku bashkohet jaka me pjesën e pasme të xhaketës në qendër.

Kostumi duhet të jetë i amablazhuar në qese polietileni.

ISTRUKSIONET E MIRËMBAJTJES



Etiketat e
mësipërm

e janë aplikuar dhe te pantallonat në pozicionet e mëposhtme:

PANTALLONAT

- Etiketa me demonstrimin e firmës furnizuese *përpara në pjesën e brendshme në bordin e poshtëm të qemerit* :
- Etiketa me udhëzimet e prerjes
- Etiketa DPI 1° kategoria sipas normativave CE
- Treguesi i përbërjes së tekstilit me vitin e fabrikimit si dhe instruksionet e larjes (mirëmbajtja)

Garancia 1 vit

2. Këmishë me mëngë të shkurtra

Këmishë me ngjyrë bezhë të çelur, me mëngë të shkurtra, me dy xhepa me kapakë (ngjyrë të zezë) me spaleta me ngjyrë të zezë. Këmisha me mëngë të shkurtra, është realizuar me tekstil ngjyrë bezhë e çelur dhe përbëhet nga këto elementë:

- Jakë klasike
- Shpina (Pjesa pas)
- Përpara (Parse me dy pjesë)
- Dy mëngë të shkurtra
- Dy xhepa në linjën e gjoksit me kapak
- Dy spaleta

Jaka: Është e përbërë nga dy pjesë (jaka dhe kama) të modeluara me formë klasike. Jaka paraqet dy ekstremitete me majë dhe është e përbërë nga dy shtresa tekstili (një shtresë e brendshme dhe një shtresë e jashtme). Shtresa e brendshme është e ndërtuar nga tekstili, kurse shtresa e jashtme është e tërësisht e termoizoluar (fiksuar) në të nxehtë sipas etapave të mëposhtme.

- Fortesa e parë e përbërë nga një shtresë tekstili e padeformueshme me bazë termoadezivi (frazelinë).
- Fortesa e dytë nga një shtresë e mbivendosur nga i njëjti tekstil si më sipër, por me një lartësi më të vogël.

Në secilën prej shtresave në qendër të tyre është fiksuar një stekë (fortesë) prej materiali plastik (rezistente ndaj temperaturës deri në 180° C), me përmasa 7x 0.7 cm (e brendshme dhe një shtresë të jashtme). Kama është e përbërë nga dy shtresa. Shtresa e jashtme është e përbërë nga vetëm një tekstil, kurse shtresa e brendshme është nga brenda e forcuar me tekstil të padeformueshëm termoadeziv (frazelinë) nëpërmjet procesit me avull në të nxehtë. Kama përfundon me dy ekstremitete (hundë) të modeluara me majë lehtësisht të rrumbullakët dhe në ekstremitetin e anës së majtë të veshur është aplikuar një vrimë horizontale rreth 20 mm e vendosur në një distancë 25 mm nga bordura, kurse në ekstremitetin e anës tjetër është montuar një kopsë plastike me ngjyrë bezhë me katër vrima e montuar me fill prej poliester qepje paralele me madhësi 20. Jaka në të tre drejtimet (anët) e lira është realizuar me tegel linear një gjilpërësh rreth 5 mm nga bordura; ndërsa kama është e përshkuar përgjatë gjithë bazës së saj me tegel linear dy gjilpërësh.

➤ Perpara

Përpara këmisha është e ndërtuar me dy pjesë. Përgjatë bordeve përpara janë aplikuar kopsat dhe vrimat për hapjen e mbylljen e këmishës. Në pjesën e majtë (të veshur) përgjatë gjatësisë së linjës qendrore është aplikuar një palosje me tekstil dopio me gjerësi rreth 40 mm e quajtur bordurë: Bordura është montuar me anë të dy tegelave linear një gjilpërësh në drejtim vertikal me rreth 5 cm distancë nga secila anë në të gjithë gjatësinë e tij. Ekstremitetet e sipërme të bordurës të realizuar në këtë mënyrë përfundojnë (fundet) të montuara në kamën e jakës dhe të fiksuara me të njëjtin tegel qepës, kurse ekstremitet e poshtme të bordurës përfundojnë të fiksuara në kthimin e palës së fundit të këmishës në një distancë rreth 5mm mbi linjën fundore të këmishës.

Në bordurë përgjatë qendrës në të njëjtin aks janë aplikuar 6 vrima vertikale, me gjatësi secila rreth 20 mm, të vendosura: e para afërsisht rreth 5 cm nga montimi i kamës së jakës, ndërsa të tjerat të barazlanguara, me distancë të njëjtë ndërmjet tyre, në funksion të prerjes. Pjesa e djathtë e bordurës përpara është realizuar në të gjithë gjatësinë e saj nga një palosje teke me tekstil dopio me gjerësi rreth 30mm, e përfunduar me tegel linear njëgjilpërësh, ekstremitetet e sipërme (fundet) të bordurës janë të montuara në brendësi të kamës së jakës (pjesa e poshtme e jakës) me të njëtin tegel qepës në pjesën e poshtme të kamës; kurse ekstremitetet e poshtme të bordurës përfundojnë të fiksuara në kthimin e palës së fundit të këmishës në një distancë rreth 5 mm mbi linjën fundore të këmishës. Në të gjithë gjatësinë e bordurës janë aplikuar:

- 6 kopsa me katër vrima të montuara me fill qepës poliestër tegeli qepës paralel dhe jo kryq me madhësi 20 të pozicionuara duke filluar në një distancë 5 cm nga bordura e sipërme (pjesa fundore e kamës).

Të dyja pjesët përfundojnë në fund me një kthim pale dyfishe (kthimi i palës së linjës fundore të këmishës).

Xhepat me kapakë: Në secilën nga pjesët përpara në lartësinë e gjoksit është montuar xhepi i realizuar me të njëjtin tekstil me atë të këmishës.

Secili xhep mbyllet me anë të kapakut me formë me “3 kulme”. Kapaku është realizuar me dy shtresa tekstili me ngjyrë të zezë.

Secili xhep është përfunduar në pjesën e sipërme me një kthim pale rreth 10 mm dhe paraqet në linjën qendrore të xhepit në gjithë gjatësinë e saj një palë vertikale me gjatësi rreth 15,5 cm dhe gjerësi 3,4 cm.

Për mbylljen e xhepit janë aplikuar 2 velkrofë “mashkull” në formë drejtkëndore me përmasa 2x2,5 cm të pozicionuar në pjesën e sipërme të xhepit dhe në distancë rreth 0,8 cm nga bordi anësor. Secili xhep mbyllet me anë të kapakut të formës me “3 kulme”. Kapaku është realizuar nga dy shtresa të të njëjtit tekstil të mbivendosura dhe nga një shtresë e brendshme e padeformueshme termoadezive (frazelinë) me proces avulli në të nxehtë. Në secilin kapak janë aplikuar dy velkrofë në formë drejtkëndore “femër” me përmasa: 2x2,5 cm në korrespondencë me dy velkrofët “mashkull” të aplikuar në xhepa. Xhepat dhe kapakët duhet të pozicionohen në simetri perfekte me njëra tjetrën, si tek Kampioni Zyrtar dhe të përfundojnë me tegel linear perimetral përgjatë bordeve.

Velkrofi: Në të djathtë të veshur mbi lartësinë e kapakut të xhepit është montuar velkrofi në formë drejtkëndor për vendosjen e numrit. Në të majtë të veshur në lartësinë e gjoksit mbi kapakun e xhepit është montuar velkrofi për vendosjen e stemës. Në velkrof është dizenuar logo e realizuar me anë të qendisjes.

Mëngët: Janë realizuar nga i njëjti tekstil, secila me një pjesë (një prerje) dhe bashkohen me trupin e këmishës në gavaturë (rreth mënge) me anë të tegelave qepës. Mënga përfundon me palën fundore.

Spaletat: Janë realizuar me tekstil me ngjyrë të zezë. Baza e secilës spaletë është montuar në rrethin e mëngës (gavaturë) kurse ekstremiteti tjetër është i lirë. Spaleta është modeluar me majë

me dimensione fikse gjatësi rreth 15 cm dhe gjerësi rreth 4,8 cm. Linja fundore e këmishës përfundon me një kthim dopio të palës së fundit e realizuar me tegel linear, me pak harkim në anësor.

Kostum me Ngjyrë të Zezë Veror (Kostum I Zi, Material i Hollë)

Të dhëna teknike të lëndës së parë:

Masa: 210g/m² ±3%

Thurja: diagonale 2+2

Përbërja: 45 % lesh + 55 poliestër ±3%

Qëndrueshmëria në abrazion: 10 000 cikle

Efekti i kokërrizmit: Nota 4-5

Qëndrueshmëria në larje

(S SH ISO 3801:1977)

(S SH ISO 7211-1:1984)

(S SH ISO 1833:2010)

(S SH ISO 12947-2:2016)

(S SH ISO 12945-2:2005)

Nota 4-5



Artikulli” Kemishe Bezhe me Menge te Shkurtra**Figura 2.** Këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë bezhë e çelur**PRERJET**

Këmishat për meshkuj janë me prerje (37-38-39-40-41-42-43-44-45-46-47-48-49). Në këto parametra është përfshirë dhe toleranca prej '1% më shumë ose më pak deri në 1cm maksimumi. Tek përmasat e jakës nuk shënohet asnjë tolerancë qepje.

TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ

[Përmasat e shprehura në cm (1/2 e përmasave reale)]

PRERJA	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49
Gjatësia e jakës.	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49
Gjatësia e pjesës së sipërme të jakës.	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53
Gjatësia pas e këmishës nisur nga jaka, pjesa pas. (bashkimi jakë / pjesë fundore).	75	76	77	78,5	80	81	82	83	84	85,5	87	88	88
Gjerësia e shpatullave (deri në linjat e qepjes).	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58
½ e Perimetrit të	52	54	56	58	60	62	64	66	68	70	72	74	76

Dokumentat Standarde të Tenderit

kraharorit (lartësia e sjetullave)													
1/2 e Perimetrit të belit (kopsa e parafundit)	46	48	50	52	54	56	58	60	62	64	66	68	70
1/2 e Perimetrit të vitheve (1/2 e pjesës fundore të këmishës).	50	52	54	56	58	60	62	64	66	68	70	72	74


ETIKETIMI DHE AMBALAZHIMI

Këmisha duhet të pajiset me një etiketë tekstili, në të cilën të shkruhet informacioni:

- Emri i prodhuesit
- Viti i prodhimit
- Masa (numri)
- Përbërja fibrore
- Instruksionet e mirëmbajtjes

Etiketa duhet të qepet në pjesën ku bashkohet jaka me pjesën e pasme të këmishës në qendër.

Këmisha duhet të jetë i amablazhuar në qese polietileni.



Aksesorët:

1. Tekstil

termvadeziv; frazelinë për përforcim të jakës të aplikuar në brendësi të tyre.

2. Kopsat:

Janë me katër vrima, me ngjyrë bezhë me fill qepës me përbërje 100% poliestër me madhësi 20.

3. FILLI QEPËS :

Për të gjithë tegelat qepës duhet të përdoret fill qepës në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- Lënda e parë: 100% poliestër
- Hollësia e fillit: 120
- Ngarkesa në shkatërrim : jo më pak se 10 N
- Zgjatueshmëria : jo më pak se 12%.
- Ngjyra:bezhë në tonalite me teksilin kryesor

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE LENDES SE PARE

Të dhëna teknikutë lëndës së parë:

Masa: 110g/m² ±3%

Thurja: garniturë1+1

Përbërja: 67% pambuk+33% poliestër ±3%

Qëndrueshmëria në abrazion: 10 000 cikle

Efekti i kokërrizmit: Nota 4-5

(S SH ISO 3801:1977)

(S SH ISO 7211-1:1984)

(ISO 1833-24:2010)

(S SH ISO 12947-2:2016)

(S SH EN ISO 12945-2:2005)

Qëndrueshmëria në larje
Kodi i ngjyrës: Pantone 7402 C
Garancia 1 vit

Nota 4-5

3. Kravatë me ngjyrat zyrtare të SHISH

Kravata është realizuar me tekstil me ngjyrë blu elektrizuese, me vijëzime diagonale ngjyrë të verdhë (ngjyrat e logos zyrtare të SHISH). Tekstili paraqet pak shkëlqim në vetvete.



Figura 3. Kravatë me ngjyrat e logos zyrtare të SHISH

TABELA E PËRMASAVE

PËRMASAT E KRAVATËS	Gjerësia e kravatës për modelin klasik në pjesën fundore.(cm)	Gjatesi kravate (cm)
STANDARDE	8 cm	160 cm
EXTRA LARGE	9.5	172 cm

ETIKETIMI

Në pjesën e pasme të kravatës në lartësinë e linjës fundore janë aplikuar etiketat e më poshtme :

- Etiketë me demonstrimin e firmës furnizuese.

Kravata duhet të pajiset me një etiketë tekstili, në të cilën të shkruhet informacioni:

- Emri i prodhuesit
- Viti i prodhimit
- Masa (numri)
- Përbërja fibrore
- Instruksionet e mirëmbajtjes

Etiketa duhet të qepet në pjesën e prapme qendër.

Kravata duhet të jetë i amablazhuar në qese polietileni.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË LËNDËS SË PARË

Të dhëna teknike të lëndës së parë:

Thurja: diagonale 2+2

(S SH ISO 7211-1:1984)

Përbërja: 100 mëndafsh±3% (ISO 1833-4:2010)

Kodi i ngjyrës: Blu Pantone 2372C
E verdhë Pantone 2012C

Garancia 1 vit

4. Këmishë me mëngë të gjata

Këmishë me ngjyrë bezhë të çelur, me mëngë të gjata, me dy xhepa me kapakë (ngjyrë të zezë) me spaleta me ngjyrë të zezë.

Këmisha me mëngë të gjata, është realizuar me tekstil ngjyrë bezhë të çelur dhe përbëhet nga këto elementë:

- Jakë klasike
- Shpina (Pjesa pas)
- Përpara (Parse me dy pjesë)
- Dy mëngë të gjata
- Dy xhepa në linjën e gjoksit me kapak
- Dy spaleta

Jaka: Është e përbërë nga dy pjesë (jaka dhe kama) të modeluara me formë klasike. Jaka paraqet dy ekstremitete me majë dhe është e përbërë nga dy shtresa tekstili (një shtresë e brendshme dhe një shtresë e jashtme).

Shtresa e brendshme është e ndërtuar nga tekstili, kurse shtresa e jashtme është e tërësisht e termoizoluar (fiksuar) në të nxehtë sipas etapave të mëposhtme.

- Fortesa e parë e përbërë nga një shtresë tekstili e padeformueshme me bazë termoadhezivi (frazelinë).
- Fortesa e dytë nga një shtresë e mbivendosur nga i njëjti tekstil si më sipër, por me një lartësi më të vogël.

Në secilën prej shtresave në qendër të tyre është fiksuar një stekë (fortesë) prej materiali plastik (rezistente ndaj temperaturës deri në 180° C), me përmasa 7x 0.7 cm (e brendshme dhe një shtresë të jashtme). Kama është e përbërë nga dy shtresa. Shtresa e jashtme është e përbërë nga vetëm një tekstil, kurse shtresa e brendshme është nga brenda e forcuar me tekstil të padeformueshëm termoadheziv (frazelinë) nëpërmjet procesit me avull në të nxehtë.

Kama përfundon me dy ekstremitete (hundë) të modeluara me majë lehtësisht të rrumbullakët dhe në ekstremitetin e anës së majtë të veshur është aplikuar një vrimë horizontale rreth 20 mm e vendosur në një distancë 25 mm nga bordura, kurse në ekstremitetin e anës tjetër është montuar një kopsë plastike me ngjyrë bezhë me katër vrima e montuar me fill prej poliester qepje paralele me madhësi 20. Jaka në të tre drejtimet (anët) e lira është realizuar me tegel linear një gjilpërësh rreth 5 mm nga bordura; ndërsa kama është e përshkuar përgjatë gjithë bazës së saj me tegel linear dy gjilpërësh.

➤ Perpara

Përpara këmisha është e ndërtuar me dy pjesë. Përgjatë bordeve përpara janë aplikuar kopsat dhe vrimat për hapjen e mbylljen e këmishës. Në pjesën e majtë (të veshur) përgjatë gjatësisë së linjës qendrore është aplikuar një palosje me tekstil dopio me gjerësi rreth 40 mm e quajtur bordurë: Bordura është montuar me anë të dy tegelave linear një gjilpërësh në drejtim vertikal me rreth 5 cm distancë nga secila anë në të gjithë gjatësinë e tij. Ekstremitetet e sipërme të bordurës të realizuar në këtë mënyrë përfundojnë (fundet) të montuara në kamën e jakës dhe të fiksuara me të njëjtin tegel qepës, kurse ekstremitetet e poshtme të bordurës përfundojnë të fiksuara në kthimin e palës së fundit të këmishës në një distancë rreth 5mm mbi linjën fundore të këmishës.

Në bordurë përgjatë qendrës në të njëjtin aks janë aplikuar 6 vrima vertikale, me gjatësi secila rreth 20 mm, të vendosura: e para afërsisht rreth 5 cm nga montimi i kamës së jakës, ndërsa të tjerat të barazlanguara, me distancë të njëjtë ndërmjet tyre, në funksion të prerjes.

Pjesa e djathtë e bordurës përpara është realizuar në të gjithë gjatësinë e saj nga një palosje teke me tekstil dopio me gjerësi rreth 30mm, e përfunduar me tegel linear njëgjilpërësh, ekstremitetet e sipërme (fundet) të bordurës janë të montuara në brendësi të kamës së jakës (pjesa e poshtme e jakës) me të njëjtin tegel qepës në pjesën e poshtme të kamës; kurse ekstremitetet e poshtme të bordurës përfundojnë të fiksuara në kthimin e palës së fundit të këmishës në një distancë rreth 5 mm mbi linjën fundore të këmishës. Në të gjithë gjatësinë e bordurës janë aplikuar:

- 6 kopsa me katër vrima të montuara me fill qepës poliestër tegeli qepës paralel dhe jo kryq me madhësi 20 të pozicionuara duke filluar në një distancë 5 cm nga bordura e sipërme (pjesa fundore e kamës).

Të dyja pjesët përfundojnë në fund me një kthim pale dyfishe (kthimi i palës së linjës fundore të këmishës).



Figura 6. Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë bezhë e çelur

Xhepat me kapakë: Në secilën nga pjesët përpara në lartësinë e gjoksit është montuar xhepi i

realizuar me të njëjtin tekstil me atë të këmishës.

Secili xhep mbyllet me anë të kapakut me formë me “3 kulme”. Kapaku është realizuar me dy shtresa tekstili me ngjyrë të zezë.

Secili xhep është përfunduar në pjesën e sipërme me një kthim pale rreth 10 mm dhe paraqet në linjën qendrore të xhepit në gjithë gjatësinë e saj një palë vertikale me gjatësi rreth 15,5 cm dhe gjerësi 3,4 cm. Për mbylljen e xhepit janë aplikuar 2 velkrofë “mashkull” në formë drejtkëndore me përmasa 2x2,5 cm të pozicionuar në pjesën e sipërme të xhepit dhe në distancë rreth 0,8 cm nga bordi anësor. Secili xhep mbyllet me anë të kapakut të formës me “3 kulme”. Kapaku është realizuar nga dy shtresa të të njëjtit tekstil të mbivendosura dhe nga një shtresë e brendshme e padeformueshme termoadezive (frazelinë) me proces avulli në të nxehtë. Në secilin kapak janë aplikuar dy velkrofë në formë drejtkëndore “femër” me përmasa: 2x2,5 cm në korrespondencë me dy velkrofët “mashkull” të aplikuar në xhepa. Xhepat dhe kapakët duhet të pozicionohen në simetri perfekte me njëra tjetrën, si tek Kampioni Zyrtar dhe të përfundojnë me tegel linear perimetral përgjatë bordeve.

Velkrofi: Në të djathtë të veshur mbi lartësinë e kapakut të xhepit është montuar velkrofi në formë drejtkëndor për vendosjen e numrit. Në të majtë të veshur në lartësinë e gjoksit mbi kapakun e xhepit është montuar velkrofi për vendosjen e stemës. Në velkrof është dizenuar logo e realizuar me anë të qendisjes.

Mëngët: Janë realizuar nga i njëjti tekstil, secila me një pjesë (një prerje) dhe bashkohen me trupin e këmishës në gavaturë (rreth mënge) me anë të tegelave qepës. Mënga përfundon me montimin e kapakut. Kapaku është i ndërtuar nga dy shtresa tekstili dhe përforcuar në brendësi me frazelinë.

Në ekstremitetin e kapakut të mëngës është realizuar një vrimë me gjatësi rreth 20 cm dhe në ekstremitetin e anës tjetër të kapakut të mëngës është aplikuar një kopsë me katër vrima me qepje në paralel të kopsës me madhësi 20. Gjithashtu anët e tjera të kapakut përfundojnë nga një tegel zbukurues me distancë sa këmba e makinës 5 mm, nga tegeli bashkues.

Gjatësia dhe gjerësia e mëngëve variojnë në bazë të prerjeve të parashikuara sic janë të përcaktuara në përmasave.

Spaletat: Janë realizuar me tekstil me ngjyrë të zezë. Baza e secilës spaletë është montuar në rrethin e mëngës (gavaturë) kurse ekstremiteti tjetër është i lirë. Spaleta është modeluar me majë me dimensione fikse gjatësi rreth 15 cm dhe gjerësi rreth 4,8 cm. Linja fundore e këmishës përfundon me një kthim dopio të palës së fundit e realizuar me tegel linear, me pak harkim në anësor.

PRERJET

Këmishat për meshkuj janë me prerje (37-38-39-40-41-42-43-44-45-46-47-48-49) dhe këmishat për femra në 12 prerje (masa) (34-35-36-37-38-39-40-41-42-43-44-45). Në këto parametra është përfshirë dhe toleranca prej 1% më shumë ose më pak deri në 1cm maksimumi. Tek përmasat e jakës nuk shënohet asnjë tolerancë qepje.

TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ

[Përmasat e shprehura në cm (1/2 e përmasave reale)]

Dokumentat Standarde të Tenderit

PRERJA	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49
Gjatësia e jakës.	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49
Gjatësia e pjesës së sipërme të jakës.	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53
Gjatësia pas e këmishës nisur nga jaka, pjesa pas. (bashkimi jakë / pjesë fundore).	75	76	77	78,5	80	81	82	83	84	85,5	87	88	88
Gjerësia e shpatullave (deri në linjat e qepjes).	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58
½ e Perimetrit të kraharorit (lartësia e sqetullave)	52	54	56	58	60	62	64	66	68	70	72	74	76
1/2 e Perimetrit të belit (kopsa e parafundit)	46	48	50	52	54	56	58	60	62	64	66	68	70
1/2 e Perimetrit të vitheve (1/2 e pjesës fundore të këmishës).	50	52	54	56	58	60	62	64	66	68	70	72	74
Gjatësia e mëngës (përfshirë kapakun e mëngës)	59	60	61	62	63	64,5	66	67,5	69	70	71	71	72
Gjerësia e kycit të dorës	23	24	24	26	26	27	27	28	28	29	29	30	30


ETIKETIMI DHE AMBALAZHIMI

Këmisha duhet të pajiset me një etiketë tekstili, në të cilën të shkruhet informacioni:

- Emri i prodhuesit
- Viti i prodhimit
- Masa (numri)
- Përbërja fibrore
- Instruksionet e mirëmbajtjes

Etiketa duhet të qepet në pjesën ku bashkohet jaka me pjesën e pasme të këmishës në qendër.

Këmisha duhet të jetë i amablazhuar në qese polietileni.



Aksesorët:

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Tekstil termvadeziv; frazelinë për përforcim të jakës dhe kapakut të mëngës të aplikuar në brendësi të tyre.

- Kopsat:

Janë me katër vrima, me ngjyrë bezhë me fill qepës me përbërje 100% poliestër me madhësi 20.

- FILLI QEPËS :

Për të gjithë tegelat qepës duhet të përdoret fill qepës në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- Lënda e parë: 100% poliestër
- Hollësia e fillit: 120
- Ngarkesa në shkatërrim : jo më pak se 10 N
- Zgjatueshmëria : jo më pak se 12%
- Ngjyra:bezhë në tonalite me teksilin kryesor

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE LENDES SE PARE

Të dhëna teknike të lëndës së parë:

Masa: 120g/m ² ±3%	(S SH ISO 3801:1977)
Thurja: garniturë1+1	(S SH ISO 7211-1:1984)
Përbërja: 67 % pambuk+33 %poliestër ±3%	(ISO 1833-24:2010)
Qëndrueshmëria në abrazion: 10 000 cikle	(S SH ISO 12947-2:2016)
Efkti i kokërrizmit: Nota 4-5	(S SH EN ISO 12945-2:2005)
Qëndrueshmëria në larje	Nota 4-5
Kodi i ngjyrës: Pantone 7402 C	

Garancia 1 vit

Kapele tip sportive, blu e errët, me logo

Kapele sportive (baseball) teksil (dok terikoton) me ngjyrë blu të errët. Kapela është realizuar me tekstil me ngjyrë të blu e errët, me një pjesë. Në pjesën ballore të kapelës, është vendosur logo e realizuar me anë të qendisje.

Në pjesën e pasme përgjatë perimetrit të kokës kapela përfundon me një shirit ku janë aplikuar aksesoret të cilët bëjnë të mundur rregullimin e gjerësisë së kapelës për përshtatjen e saj me formën e kokës.



Figura 7. Kapelë blu e errët me logo

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE LENDES SE PARE

Të dhëna teknike të lëndës së parë:

Masa: 200g/m ² ±3%	(S SH ISO 3801:1977)
Thurja: diagonale 2+2	(S SH ISO 7211-1:1984)
Përbërja: 67% pambuk+33% poliestër ±3%	(ISO 1833-24:2010)
Qëndrueshmëria në abrazion: 10 000 cikle	(S SH ISO 12947-2:2016)
Efekti i kokërrizmit: Nota 4-5	(S SH EN ISO 12945-2:2005)
Qëndrueshmëria në larje	Nota 4-5
Kodi i ngjyrës:	Pantone 282 C

5. Pulover e trikotuar me jakë “V”, ngjyrë blu e errët

Pulovra është modeluar me jakë “V”, me trikotazh ngjyrë blu të errët. Është konfeksionuar në 8 prerje unisex (XS-S-M-L-XL-XXL-XXXL-4XL). Pulovra është e ndërtuar nga këto elementë

- Përpara
- Pjesa e pasme
- Jaka
- Dy mëngë të gjata
- Dy shtresa tekstili prej pambuku (përforcues) të aplikuara përgjatë linjës së supeve me vazhdim në pjesën përpara dhe pas.



Figura 8. Pulovër jakë “V” me ngjyrë blu të errët

Pjesa përpara dhe pas janë realizuar me një pjesë të vetme pa prerje me punim trikotazhthurje interlog në linjën fundore përfundojnë me një bordurë e cila është realizuar me punim trikotazhthurje llastik. Ky lloj punimi bën të mundur që bordura fundore e pulovrës të qëndrojë sipas perimetrit të adomeve.

MËNGË TË GJATA

Janë në formë tubolare të realizuara me një pjesë dhe bashkohen me anë të tegelit të poshtëm përgjatë gjithë gjatësisë së tyre. Janë realizuar me punim trikotazhthurje interlog dhe në linjën fundore të tyre përfundojnë me një bordurë trikotazhthurje llastik 1/1 me gjatësi rreth 6,5 cm. Mëngët bashkohen me trupin e pulovrës me anë të tegelit syzator.

PËRFORCUES TË APLIKUAR NË SUPE

Janë realizuar me tekstil pambuku miks me formë drejtkëndore përmasat e të cilëve variojnë në bazë të prerjes. Këto përforcues janë të pozicionuar në linjën e supit, pra të aplikuar përgjatë pjesës përpara dhe prapa të pulovrës; nëpërmjet tegelit qepës perimetral tre gjilpërësh me fill).

TABELA E MASAVE

(PËRMASAT E SHPREHURA NË CM – TOLERANCË +/- 3%)

PËRMASAT E VESHJES	XS	S	M	L	XL	XXL	XXXL	4XL
Gjatësia totale (nga kulmi i supit deri në linjën fundore)	63	65	67	68	70	71	72	73
1/2 e Gjerësisë së gjoksit (e matur 2 cm nën linjën e sektorit).	50	52	54	56	58	60	62	64
1/2 e Gjerësisë së shpatullave	38	40	42	44	46	48	50	52
Gjatësia e mëngës	59	60	61	62	63	64	65	66
Gjerësia e Gavaturës së mëngës	22	23	24	25	26	27	27	27
Lartësia e mëngës ,Koka e mëngës	18	19	20	21	22	23	23	23

1/2 e Gjerësisë së kycit të dorës (pulsit)	10	10	10	10	11	11	11	11
--	----	----	----	----	----	----	----	----

PËRMASAT E PËRBASHKËTA PËR TË GJITHA PRERJET


- Lartësia e bordurës së linjës fundore 6,5 cm
- Lartësia e pulsit (linjës së kyçit të dorës) 6,5 cm
- Gjatësia e hapjes së jakës 19 cm

ETIKETIMI

Në pjesën e brendshme të pulovrës në lartësinë e jakës, përgjatë tegelit bashkues janë aplikuar etiketat e mëposhtme:

- Etiketa e firmës furnizuese
- Etiketa me udhëzimet e prerjes
Në brendësi të linjës anësore:
- Treguesi i përbërjes së tekstilit si dhe instruksionet e larjes (mirëmbajtja)

AKSESOR:



FILLI

- Ngjyra : në tonalitet me produktin

QEPËS

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE LENDES SE PARE

Të dhëna teknike të lëndës së parë:

Masa: 400g/m ² ±3%	(S SH ISO 3801:1977)
Thurja e copës bazë: Interlock	(S SH ISO 7211-1:1984)
Thurja e pjesës fundore të mëngëve: Ilastik 2+2	(S SH ISO 7211-1:1984)
Përbërja: 50 % lesh+50 akrilik±3%	(ISO 1833-4:2010)
Qëndrueshmëria në abrazion: 10 000 cikle	(S SH ISO 12947-2:2016)
Efekti i kokërrizmit: Nota 4	(S SH EN ISO 12945-2:2005)
Qëndrueshmëria në larje	Nota 4-5
Kodi i ngjyrës: Pantone 282 C	

Garancia 1 vit

6. Xhup me veshje të ngrohtë, ngjyrë blu e errët.(XHUP ¾ SINTETIK)

Xhupi dimëror është realizuar me tekstil me ngjyrë blu të errët, me veshje të ngrohtë. Xhup tre shtresor (shtresa e parë tekstil i rezistent ndaj ujit), shtresa e dytë vatinë, shtresa e tretë astar). Është konfeksionuar në 8 prerje (XS-S-M-L-XL-XXL-XXXL-4XL). Në lartësinë e gjoksit përpara është aplikuar: një velkrof drejtkëndor me dimensione 10X3,5 cm në të cilin është

dizenjuar shkrimi “SIGURIA” me fill qendisës me ngjyrë të verdhë.

Xhupi treçereksh është realizuar me tekstil të papërshkueshëm ndaj shiut dhe përbëhet nga këto elementë:

- Përpara (me dy pjesë)
- Pjesa pas
- Jaka
- Dy mëngë
- Një shtresë e brendshme e heqshme
- Astari



Figura 9. Xhup me veshje të ngrohtë, blu i errët

1. PËRPARA

Është realizuar me dy pjesë, të bashkuar ndërmjet tyre përgjatë linjës qendrore në të gjithë gjatësinë e saj me anë të një zinxhiri tip 8 dhëmbësh të padukshëm; nga jashtë anët e zinxhirit janë të mbuluara me anë të një mostre të realizuar me tekstil dopio me gjerësi rreth 1 cm. Në brendësi në afërsi të zinxhirit dy pjesët përpara paraqesin një palosje me tekstil dopio me gjerësi rreth 5 cm, të realizuar me tegel qepës rreth 1 cm nga bordet. Përpara xhiboksi është realizuar nga dy pjesë, të cilat bashkohen (mbyllen) ndërmjet tyre në linjën qendrore në drejtim vertikal.

Në secilën pjesë përpara, në lartësinë e belit është aplikuar një xhep fileto mbi të cilin janë montuar kapakët. Kapakët e xhepave janë montuar në drejtim diagonal. Në linjën fundore të dy pjesët përfundojnë me një kthim pale me lartësi rreth 2 cm. Në anën e djathtë të veshur, në lartësinë e linjës së gjoksit është montuar një velkrof drejtkëndor me shkrimin “SIGURIA”. Shkrimi është realizuar me fill qendisës me ngjyrë të verdhë. Xhupi përfundon me një kthim pale me të njëjtin tekstil dhe është realizuar dhe në linjën fundore nga brenda deri në distancën rreth 12 cm, (përmasa varion në bazë të prerjes) në pjesën e sipërme të së cilës është montuar

vazhdimi i astarit të brendshëm.

2. PJESA E PASME

Është realizuar drejt pa prerje dhe bashkohet me mëngët, pjesët përpara dhe jakën nëpërmjet tegelit të brendshëm syzator. Në tegelin bashkues të mëngëve me pjesën e pasme janë realizuar dy shtesa me gjerësi rreth 6 cm; të cilat fillojnë që nga tegeli bashkues i linjës së supeve, rreth 1,5 cm nga bordi i jashtëm dhe përfundojnë në tegelin qepës bashkues të pjesëve përpara me pjesën e pasme në anësor.

3. JAKA

Është realizuar me tekstil dopio të njëjtë me atë të xhupit. Jaka është model korean dhe ka lartësi rreth 7.5 cm. Ajo bashkohet trupin e xhupit me anë të tegelave qepës.

4. MËNGËT

Jënë realizuar me dy pjesë një mëngë e sipërme dhe një mëngë e poshtme. Mëngët janë realizuar me tekstil të njëjtë me atë të xhupit. Dy pjesët bashkohen me tegel syzator në pjesën e poshtme dhe në pjesën e sipërme me tegel syzator i cili përshkon modelimin e formës së brrylit për të patur një lirshmëri më të mirë. Dy mëngët përfundojnë në linjën fundore me një palosje të brendshme me lartësi rreth 2 cm dhe bashkohen me astarin e brendshëm nëpërmjet tegelit qepës. Pjesa fundore e mëngës paraqet në tegeli qepës të poshtëm në të dy pjesët përbërëse të saj, gjuhëz e cila shërben për rregullimin e perimetrit të kycit të dorës.

5. PJESA E BRENDSHME E ÇMONTUESHME

Në brendësi të xhupit ndërmjet tekstit të jashtëm dhe astarit të xhupit, është aplikuar një “xhup” i brendshëm i realizuar me një shtresë me mbushje me vatinë me e cila është aplikuar ndërmjet dy shtresave të tekstit 100% poliestër (astar) të realizuar me tegela në formë romboidale (rreth 5 cm për anë). Kjo është aplikuar në pjesën e brendshme të xhupit nëpërmjet dy pjesëve të zinxhirit të aplikuara përgjatë saj. Në brendësi bashkohen me anë të dy pjesëve zinxhirit të aplikuar në palosjen e brendshme (paramonturë). Zinxhirirët janë montuar me anë të tegelit qepës një gjilpërësh.

6. ASTARI

Është realizuar me tekstil me ngjyrë të zezë i aplikuar në brendësi të xhupit.

TABELA E PËRMASAVE

(DIMENSIONET E SHPREHURA NË CM – TOLERANCË +/- 3%)

	XS	S	M	L	XL	XXL	XXXL	4XL
1/2 e Gjerësisë së kraharorit (e matur në pjesën e poshtme të sektorit)	60	60	64	70	73	79	81	84
Gjerësi shpatullash	47	47	51	53	55	57	59	62
Gjatësia totale (e matur nga tegeli qepës i linjës së supeve në afërsitë jakës deri në fund)	64	67	71	74	77	79	81	83
Gjatësia e mëngës (e matur duke ndjekur formën e modelimit të	59	59	65	67	69	70	73	73

brrylit)								
----------	--	--	--	--	--	--	--	--

AKSESORËT

1. FILLI QEPËS

- Ngjyra: në tonalitet me produktin
- Lënda e parë: 100% poliestër
- Hollësia e fillit: 75

2. ASTARI TEKSTIL RRJETË I BRENDSHËM: 100% poliamid

3. MBUSHJA ME VATINE: 100% poliestër (vatinë e brendshme)

4. ZINXHIRET DHE KOPSAT

- Zinxhir i padukshëm tip 8 dhëmbësh
- Zinxhir i padukshëm tip spiral 5 fiks 5
- Kopsa blu plastike me katër vrima me madhësi 24
- Kopsa të blu plastike me katër vrima me madhësi 30

ETIKETIMI DHE AMBALAZHIMI


Xhupi dimëror duhet të pajiset me një etiketë tekstili, në të cilën të shkruhet informacioni:

- Emri i prodhuesit
- Viti i prodhimit
- Masa (numri)
- Përbërja fibrore
- Instruksionet e mirëmbajtjes

Etiketa duhet të qepet në pjesën ku bashkohet jaka me pjesën e pasme të xhupit në qendër.

MIREMBAJTJA

Instruksionet e larjes janë aplikuar në etiketë.



Xhupi dimëror duhet të jetë i amablazhuar në qese polietileni.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE LENDES SE PARE

Të dhëna teknike të lëndës së parë:

Shtresa e parë

Masa: 240g/m² ±3%

Thurja: garniturë 1+1

Përbërja: 100 % polyester

Qëndrueshmëria në abrazion: 15 000 cikle

Efekti i kokërrizmit: Nota 4-5

(S SH ISO 3801:1977)

(S SH ISO 7211-1:1984)

(ISO 1833-24:2010)

(S SH ISO 12947-2:2016)

(S SH EN ISO 12945-2:2005)

Qëndrueshmëria në larje
Kodi i ngjyrës Pantone 289

Nota 4-5

Shtresa e dytë (vatinë)

Përbërja: 100 % polyester

Masa: 40g/m² ±3%

(ISO 1833-24:2010)

(S SH ISO 3801:1977)

Shtresa e tretë (astar)

Përbërja: 100 % polyester

Masa: 90g/m² ±3%

Thurja: diagonale

Ngjyra: e zezë

(ISO 1833-24:2010)

(S SH ISO 3801:1977)

(S SH ISO 7211-1:1984)

Logoja e Shërbimit Informativ të Shtetit

Logo me qëndisje me relief, e heqshme nga uniforma për këmishën me diametër 8 cm. Logo e qëndisur në kapele me diametër 5 cm.



Numri identifikues

Numri identifikues i shkruar në shirit me ngjyrë blu si të logos zyrtare, i qëndisur me relief me përmasa 8 cm x 3 cm, i heqshëm për t'u vendosur në këmishë.



Shirit me fjalën “SIGURIA”

Fjala “SIGURIA” e shkruar në shirit me ngjyrë blu si të logos zyrtare, e qëndisur me relief me përmasa 8 cm x 3 cm, e heqshme për t'u vendosur në xhup.



Shtojca11

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia matese	Sasite e pritshme
1	Xhup 3/4 sintetik	copë	180
2	Kostume verore (i zi)	komplet	180
3	Kostume dimërore (i zi)	komplet	180
4	Kemishë me mëngë të shkurta	copë	360
5	Këmishë me mëngë të gjata	copë	360
6	Pulovër	copë	180
7	Kravate	copë	360
8	Kapele	copë	180
9	Logo SHISH	copë	180
10	Numri identifikues	copë	180
11	Shirit me fjalën "Siguria"	copë	180

Afatet e lëvrimit: 45 ditë nga lidhja e kontratës/kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

Shtojca 13

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Dokumentat Standarde të Tenderit

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|----------|-------|
| 1. _____ | _____ |
|----------|-------|

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktuesi” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.

- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe pakeluar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe pakeluar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimit.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 Ekzekutimi i testeve, apo inspektimi i Mallrave nuk e shkarkojnë Kontraktuesin nga garancitë apo detyrimet e tjera sipas kontratës.

Neni 13: Kushtet e Dorëzimit

- 13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit

përveçse kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

- 13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.
- 13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve të lidhura me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.
- 13.4 Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim të rastit kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.
- 13.5 Kontraktuesi është i detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një periudhe kohore të arsyeshme për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.

Neni 14 Transportimi i Mallrave

- 14.1 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin e Mallrave siç kërkohet, me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuar në kontratë.
- 14.2 Në Autoriteti Kontraktor është i detyruar të marrë Mallrat nga ndonjë mjet transporti apo agjenci transporti, Kontraktuesi duhet të japë lajmërim paraprak të arsyeshëm për transportin dhe t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave.
- 14.3 Nëse shitësi, [Kontraktuesi] është i detyruar t'i dorëzojë mallrat në mjetin e transportit në një vend të specifikuar në kontratë, risku i humbjes kalon tek Autoriteti Kontraktor vetëm kur mallrat i dorëzohen mjetit të transportit në vendin e specifikuar. Fakti se shitësi [Kontraktuesi] është i autorizuar të mbajë dokumentat përfaqësuese të mallrave nuk influencon në kalimin e riskut.

Neni 15: Siguracioni

- 15.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi duhet të sigurojë që Mallrat që do të dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruar ndaj humbjes ose dëmtimit gjatë transportit, magazinimit ose dorëzimit të tyre.

Neni 16: Verifikimi dhe Pranimi i Mallrave

